



**REPUBLIKA E KOSOVËS**  
**REPUBLIKA KOSOVA – REPUBLIC OF KOSOVO**  
**GJYKATA SUPREME E KOSOVËS**  
**VRHOVNI SUD KOSOVA – SUPREME COURT OF KOSOVO**

---

Gjykata Supreme e Republikës së Kosovës, në seancën e përgjithshme të gjithë gjyqtarëve, në bazë të nenit 26, paragrafi 1, nën-paragrafi 1.4. dhe nenit 27, paragrafi 1. të Ligjit për Gjykatat (Ligji Nr. 06/L -054, i datës 23 nëntor 2018), më datën 27 shkurt 2023, me vota unanime, miraton këtë:

**U D H Ë Z U E S**

**I. a).** Në konfliktet administrative të iniciuara nga Shoqëritë Tregtare kundër vendimeve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative për të cilat Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar dhe ka juridiksion ekskluziv, siç parashihet në nenin 13 par. 1 pika 1.11 të Ligjit për Gjykatën Komerciale (kontestet kundër vendimeve përfundimtare të ATK, Doganave të Kosovës, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve shtetërore), përveç Ligjit për Gjykatën Komerciale, ashtu siç parashihet në nenin 21, par. 2, të tij, duhet të aplikohen:

- Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr.03/L-222 si dhe plotësim ndryshimi i këtij ligji nr. 04/L-102;

- Ligji për Konfliktet Administrative, nr.03/L-202, si dhe

- Ligji i Procedurës Kontestimore.

**I. b).** Në konfliktet Administrative të iniciuara nga Shoqëritë Tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative, për të cilat Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar, siç parashihet në nenin 13, par. 1, pika 1.12, të Ligjit për Gjykatën Komerciale,

përveç ligjit bazë për Gjykatën Komerciale, duhet të aplikohet Ligji për Konfliktet Administrative (LKA) dhe nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative atëherë zbatohen dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore (LPK), ashtu siç është parapa në nenin 63 të LKA.

**II.** Në konfliktet administrative të përcaktuara si në pikën I.a të këtij udhëzuesi në procedurën sipas ankesës kundër vendimeve të gjykatës së shkallës së parë aplikohet Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat si dhe plotësim ndryshimet e këtij ligji (Ligji nr. 04/L102 dhe plotësim ndryshimin nr. 03/L-222), ndërsa për rastet tjera që nuk janë rregulluar me këtë ligj aplikohen dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative dhe Ligjit për Procedurën Kontestimore.

**III. a).** Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor (siç parashihet me nenet 24 dhe 50-54 të LKA), mund të parashtrohet kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë (Gjykatës Komerciale, Departamentit Fiskal dhe Administrativ), por jo edhe kundër vendimeve të Departamentit për çështje ekonomike dhe të përgjithshëm.

**III. b).** Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor mund të paraqitet kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë (Gjykatës Komerciale, Departamentit Fiskal dhe Administrativ), për caktimin e masës së përkohshme përkatësisht shtyrjen e ekzekutimit të vendimit përfundimtarë administrativ, siç është përcaktuar me nenin 22 të Ligjit për Konflikte Administrative

**III. c).** Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor kundër vendimeve të Gjykatës Komerciale - Departamentit Fiskal dhe Departamentit Administrativ, nuk është e kufizuar me vlerën e kontestit, ashtu siç është përcaktuar me nenin 14.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

## A r s y e t i m

Kolegjiumi i Gjyqtarëve të Gjykatës Komerciale të Dhomës së Shkallës së Parë dhe të Dytë i janë drejtuar Gjykatës Supreme me kërkesë për dhënie të Mendimit Juridik, me qëllim të zbatimit unik të ligjeve nga gjykatat e sistemit gjyqësor të Kosovës, ngase me hyrjen në fuqi të Ligjit për Gjykatën Komerciale në disa nene të këtij ligji janë paraqitur paqartësi në lidhje me

çështjet që bien në kompetencë të kësaj gjykate sipas nenit 13 par. 1, nën par. 1.11 dhe 1.12, ku janë parashtruar pyetjet si në vijim:

1. *Pas hyrjes në fuqi të ligjit 08/L-015, për Gjykatën Komerciale, për kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative siç janë përcaktuar me nenin 13, paragrafi 1.11 dhe 1.12 të këtij ligji, si ligj procedural dhe material, në trajtimin e këtyre rasteve nga Departamenti Fiskal dhe Administrativ i Gjykatës Komerciale, cili ligj duhet të aplikohet, përjashtoj ligjin bazë si më lartë, dhe cili ligj ka epërsi ndaj tjetrit:*

- ligji 03/L-202 për Konfliktin Administrativ apo
- ligji 03/L-004 për procedurën Kontestimore.

2. *Cilat afate për ankesë kundër aktgjykimit apo aktvendimit të nxjerr nga Departamenti Fiskal dhe Administrativ në kompetencë të tyre siç janë përcaktuar me nenin 13, paragrafi 1.11 dhe 1.12 të ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale, aplikohen: neni 49, par 2, i ligjit 03/L-202 për Konfliktin Administrativ apo neni 509, pika c), e ligjit 03/L-004 për procedurën kontestimore, dhe*

3. *Mjeti i jashtëzakonshëm juridik, kërkesat për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor e paraparë me nenin 50, par 1 të ligjit 03/L-202 për Konfliktin Administrativ,*

- *a aplikohet ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës komerciale,*
- *a aplikohet ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës komerciale lidhur me masat e sigurisë, respektivisht kërkesat për shtyrje të ekzekutimit, dhe*
- *a është i lidhur ky mjet me vlerë kontesti sikurse Revizioni i përcaktuar me nenin 14, par 2 të Ligjit 08/L-015 për Gjykatën Komerciale.*

Gjykata Supreme e Kosovës e vlerëson me interes për standardizimin e praktikës gjyqësore, adresimin e këtyre çështjeve përmes një udhëzuesi juridik, nxjerrja e të cilit do t'i kontribuojë unifikimit të praktikës gjyqësore, vendosjes së standardit të ligjshmërisë në vendimmarrjen gjyqësore për çështjet e tilla, performancës së gjyqtarëve dhe besimit të publikut në gjykata. Kjo për shkak se përmes standardizimit të praktikës gjyqësore ndikohet në ligjshmërinë e vendimmarrjes, efikasitetin dhe besueshmërinë e publikut në gjykata.

Juridiksioni i Gjykatës Supreme të Kosovës, që të nxjerrë udhëzues juridik në rastet kur vërehet praktika jo unike e zbatimit të ligjit nga gjykatat e rregullta, apo sfidat në zbatimin dhe interpretimin e dispozitave ligjore, përcaktohet me Ligjin për Gjykatat. Me nenin 27 të këtij

ligji, përcaktohet se Seanca e Përgjithshme e të gjithë gjyqtarëve të Gjykatës Supreme të Kosovës ka të drejtë të nxjerrë udhëzues juridik, qëndrime parimore dhe mendime juridike me qëllim të unifikimit të praktikës gjyqësore, ndërsa nevoja e adresimit të kësaj çështjeje përmes një udhëzuesi juridik ka rrjedhur si propozim dhe konkludim i kësaj gjykate, pas shqyrtimit, analizës dhe vlerësimit të kërkesës për dhënie të këtij udhëzuesi juridik.

Në vazhdim paraqiten arsyet lidhur me vendosjen sipas kronologjisë së dispozitivit të këtij Udhëzuesi.

#### **Arsyetimi i pikës I. a) të dispozitivit**

Ligji për Gjykatën Komerciale në nenin 21 par. 2, ka përcaktuar se: *“Për të gjitha çështjet që nuk janë rregulluar me këtë ligj zbatohen dispozitat e ligjeve tjera materiale dhe procedurale në fuqi, përveç nëse ndryshe parashihet shprehimisht me këtë ligj”*. Ndërsa Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222 dhe plotësim ndryshimi i këtij ligji nr. 04/L-102 ( që nga përmbajtja rezulton se është ligj special i natyrës materiale dhe procedurale), me nenin 81.C, të plotësim ndryshimit të ligjit ka përcaktuar se: *“Për çështjet që nuk rregullohen me këtë ligj në lidhje me përgjegjësitë dhe rregullat procedurale të gjykatave kompetente, ligji për konflikte administrative plotësim dhe ndryshim i ligjit 03/L202 dhe çdo ligj tjetër në fuqi në Kosovë duhet të zbatohet. Në rast të kundërshtimeve të këtij ligji me ligjet tjera dispozitat që gjenden në këtë ligj duhet të mbizotërojnë”*. Nga kjo rezulton se në kontestet administrative të iniciuara nga shoqëritë tregtare kundër vendimeve përfundimtare të nxjerra në procedurë administrative, siç janë përcaktuar me nenin 13.par.1 pika 1.11, të këtij ligji, të vendimeve të ATK, Doganave të Kosovës, Ministrisë së Financave dhe çdo organi tjetër publik për vendosjen e tatimeve ose detyrimeve shtetërore, përveç ligjit për Gjykatën Komerciale, aq sa rregullon çështje konkrete, duhet të aplikohet Ligji për Administratën Tatimore dhe Procedurat dhe plotësim ndryshimi i këtij ligji, pastaj dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative dhe nëse ky ligj nuk përmban dispozita për procedurën në konfliktet administrative atëherë vjen në shprehje zbatimi përshtatshmërisht i dispozitave të Ligjit për Procedurën Kontestimore (neni 63 të LKA).

#### **Arsyetimi i pikës I.b) të dispozitivit.**

Sipas kësaj gjykate në kontestet e iniciuara nga shoqëritë tregtare, kundër vendimeve përfundimtare në procedurë administrative siç përcaktohet në nenin 13 par. 1 pika 1.12 të Ligjit për Gjykatën Komerciale, për të cilat Gjykata Komerciale është kompetente për të gjykuar

sipas nenit 4 të këtij ligji, përveç ligjit për Gjykatën Komerciale duhet të aplikohet Ligji për Konfliktet Administrative i cili rregullon kompetencën, përbërjen e gjykatës dhe rregullat e procedurës në bazë të cilave gjykatat kompetente vendosin për ligjshmërinë e akteve administrative, ndërsa dispozitat e Ligjit për Procedurën Kontestimore aplikohen vetëm në rastet kur Ligji për Konfliktin Administrativ nuk përmban dispozita që rregullojnë procedurat në konfliktet administrative ( neni 63 të LKA dhe nenin 21, par. 2, i Ligjit për Gjykatën Komerciale).

### **Arsyetimi i pikës II, të dispozitivit.**

Me vendosjen si në pikën II të dispozitivit të udhëzuesit është dhënë përgjigja në çështjen e ngritur lidhur me atë se cilat janë afatet për ankesë kundër vendimeve të Gjykatës Komerciale të Departamentit Fiskal dhe Administrativ, si dhe afati a duhet llogaritur sipas nenit 49 të Ligjit për Konflikte Administrative apo sipas nenin 509 pika c) të Ligjit për Procedurën Kontestimore. Baza ligjore për të vendosur në këtë çështje mbështetet në Ligjin nr.04/L102 për Ndryshimin dhe Plotësimin e Ligjit për Administratën Tatimore dhe Procedurat nr. 03/L-222, ku me nenin 81.C përcaktohet se: *“Për çështjet që nuk rregullohen me këtë ligj në lidhje me përgjegjësit dhe rregullat procedurale të gjykatave kompetente, ligji mbi konfliktet administrative, plotësim ndryshimi i ligjit 03/L-202 dhe çdo ligj tjetër në fuqi në Kosovë duhet të zbatohet. Në rast të kundërshtimeve të këtij ligji me ligjet tjera, dispozitat që gjenden në këtë ligj duhet të mbizotërojnë”* Ndërsa me nenin 81.1 H. pika 5 të këtij ligji përcaktohet se: *“Vendimi i Gjykatës themelore mund të kundërshtohet përmes gjykatës kompetente brenda afatit gjashtëdhjetë (60) ditëve të komunikimit të tij zyrtar tek palët”*.

Bazuar në dispozitat e lartë cituara rezulton se me ligj të veçantë është përcaktuar afati i ankesës kundër vendimeve të marra nga Gjykata Themelore, që do të thotë se afatet për ankesë kundër vendimeve të Gjykatës Komerciale të Departamentit Fiskal dhe Administrativ duhet të llogariten sipas Ligjit për ATK dhe Procedurat. Ndërsa në rastet tjera kur me ligj të veçantë nuk është rregulluar procedura për mjetet juridike kundër vendimeve që janë nxjerr nga Departamenti Fiskal dhe Administrativ, atëherë për këto çështje duhet të aplikohet neni 49 lidhur me nenin 28 të Ligjit për Konfliktet Administrative, i cili e rregullon procedurën dhe afatin e ankesës kundër vendimit të gjykatës. Përveç kësaj, në çështjet tjera procedurale në kontestet tregtare por edhe administrative që kanë të bëjnë me afatet dhe llogaritjen e tyre, mirëpo nuk janë rregulluara sipas ligjeve të lartë cekura, atëherë aplikohen dispozitat e LPK-

së, ashtu siç është përcaktuar në nenin 21, par. 2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale dhe nenin 63 të LKA.

#### **Arsyetimi i pikës III.a) të dispozitivit.**

Për të vendosur si në pikën III.a) të dispozitivit të këtij udhëzuesi, gjykata i është referuar nenin 14 par.1, të Ligjit për Gjykatën Komerciale, me të cilën dispozitë është përcaktuar se: *“Lidhur me kërkesat për mjetet e jashtëzakonshme juridike kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale, të Republikës së Kosovës, zbatohen ligjet procedurale në fuqi”*. Ndërsa me nenin 24 të Ligjit për Konfliktet Administrative është përcaktuar se: *“Kundër vendimit të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë, pala mund të parashtroj në Gjykatë Supreme kërkesë për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor”*, kurse me nenin 50 të këtij ligji është përcaktuar se: *“Kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor i dërgohet gjykatës brenda afatit prej 30 ditë nga dita e pranimit kundër të cilit pala paraqet kërkesën”*

Nga dispozitat e cituara më lartë rezulton se kundër vendimeve përfundimtare të Gjykatës Komerciale - Departamentit Fiskal dhe Departamentit Administrativ mund të parashtrohet në Gjykatë Supreme mjete juridik i jashtëzakonshëm kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor, dhe atë brenda afatit prej 30 ditë nga dita e pranimit të vendimit, ashtu siç është përcaktuar me dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative si ligj procedural në fuqi i cili edhe duhet të zbatohet në këto raste, por jo edhe kundër vendimeve të Departamentit për çështje ekonomike dhe të përgjithshëm.

#### **Arsyetimi i pikës III.b) të dispozitivit.**

Për të vendosur lidhur me çështjen e ngritur se mjete i jashtëzakonshëm juridik, kërkesat për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor a aplikohet ndaj vendimeve përfundimtare të gjykatës komerciale lidhur me masat e sigurisë, respektivisht kërkesat për shtyrje të ekzekutimit, kjo gjykatë si bazë ka marrë Ligjin për Konfliktet Administrative, ku me nenin 22.1 është përcaktuar se: *“Padia nuk e ndalon ekzekutimin e aktit administrativ kundër të cilit është paraqitur përveç kur kjo me ligj është parashikuar ndryshe”*, ndërsa me paragrafin 2 të këtij neni është përcaktuar se: *“Me kërkesën e paditësit organi akti i të cilit ekzekutohet gjegjësisht organi që është kompetent për ekzekutim, mund ta shtyj ekzekutimin deri në vendimin definitiv gjyqësor nëse ekzekutimi do të sillte dëm paditësit i cili vështirë do të riparohej ,kurse shtyrja nuk është në kundërshtim me interesin publik , e as që shtyrja do ti*

*sillte ndonjë dëm të madh palës kundërshtare përkatësisht personit të interesuar“, si dhe me paragrafin 6 të këtij neni është përcaktuar se: “Paditësi mund të kërkoj edhe nga gjykata shtyrjen e ekzekutimit të aktit administrativ deri në marrjen e vendimit gjyqësor sipas kushteve të parapara në paragrafin 2 të këtij neni”*

Referuar kësaj baze ligjore por duke u nisur edhe nga ajo që Ligjit për Gjykatën Komerciale përkatësisht neni 14 i këtij ligji parasheh mjetet e jashtëzakonshme juridike, ndërsa me asnjë dispozitë tjetër të LKA apo të Gjykatës Komerciale nuk është kufizuar apo ndaluar se kundër vendimit të shkallës së dytë të Gjykatës Komerciale nuk mund të ushtrohet mjete juridik i jashtëzakonshëm, atëherë kjo gjykatë vlerëson se mjete juridik i jashtëzakonshëm kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor mund të paraqitet në Gjykatë Supreme kundër vendimeve të formës së prerë të gjykatës kompetente për çështje administrative të shkallës së dytë (Gjykatës Komerciale, Departamentit Fiskal dhe Administrativ), të nxjerra sipas nenit 22 të Ligjit për Konflikte Administrative, i cili e rregullon masën e përkohshme përkatësisht shtyrjen e ekzekutimit të vendimit përfundimtarë administrativ sipas kërkesës së paditësit.

#### **Arsyetimi i pikës III.c) të dispozitivit.**

Çështja tjetër që është ngritur për t’u trajtuar është se paraqitja e mjetit juridik të jashtëzakonshëm kërkesës për rishqyrtim të jashtëzakonshëm të vendimit gjyqësor në këto konteste a është e lidhur me vlerën e kontesteve për të cilat mund të paraqitet revizioni, ashtu siç është përcaktuar me nenin 14.2 të Ligjit për Gjykatën Komerciale.

Kjo gjykatë vlerëson se nisur nga fakti që mjetit juridik i jashtëzakonshëm kërkesa për rishqyrtim të jashtëzakonshëm ka të bëjë me vendimet e Departamentit Fiskal dhe Administrativ, ndërsa për këto konteste përfshirë edhe paraqitjen e mjeteve juridike të jashtëzakonshme aplikohen dispozitat e Ligjit për Konfliktet Administrative, rezulton se në asnjë rrethanë ky mjet juridik nuk mund të identifikohet me revizionin e as të kushtëzohet ushtrimi i tij në pikëpamje të vlerës së kontestit ashtu siç kushtëzohet paraqitja e revizionit.

*(Udhëzuesi i miratuar në Seancën e Përgjithshme të Gjykatës Supreme, mbajtur me datë 27 shkurt 2023)*